

FJALA E DEPUTETES SHPRESA MARNOJ

E ENJTE 9 DHJETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot po shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë Covid-19”. Qëllimi i marrjes së kësaj huaje është që, nëpërmjet instrumentit të mbështetjes buxhetore, të sigurohen fonde financiare të nevojshme për financimin e shpenzimeve buxhetore për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia, ku në fokus është parandalimi dhe reagimi ndaj rrezikut që paraqet Covid-19 dhe mbrojtja e shëndetit publik në tërësi, si dhe fuqizimi i sistemeve kombëtare të gatishmërisë së shëndetit publik, ku pikat kryesore të financimit të shpenzimeve të jashtëzakonshme, që lindin nga pandemia, janë: punësimi i personelit të ri mjekësor (mjekë, infermierë dhe ndihmësinfermierë), punë jashtë orarit për personelin mjekësor dhe jomjekësor; blerja e pajisjeve mjekësore; furnizime farmaceutike, siç janë medikamentet ose testet diagnostikuese; materiale konsumi, si maska, doreza, dezinfektantë, pajisje mbrojtëse personale për punonjësit e kujdesit shëndetësor; rehabilitimi dhe përshtatja e spitaleve dhe vaksinat Covid-19, përfshirë kostot e transportit dhe të magazinimit.

Huaja financiare, sipas kësaj marrëveshjeje, ka terma financiarë të butë, ku shuma e huas është 60 milionë euro. Maturimi është 15 vjet, në varësi të periudhës maksimale pa pagesë principali, të përcaktuar në momentin e disbursimit. Interesi përcaktohet mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit dhe huaja disbursohet minimalisht në dy transhe, sipas kapacitetit përthithës të projektit, ku shuma e transhit të parë nuk mund të jetë më e madhe se 70% e huas. Për të mos u zgjatur më tej në specifikime, dua të ndalem te mbështetja kryesore e kësaj huaje, që konsiston në dy pika kryesore, në furnizimin e sistemit shëndetësor për rritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve me Covid-19 e të sëmundjeve që lidhen me të dhe në sigurimin e vaksinës Covid-19. Është kjo pikërisht pika ku dua të ndalem dhe të theksoj rëndësinë që ajo ka në jetën dhe shëndetin e qytetarëve sot. Që nga fillimi i pandemisë jemi përballur me sfida të ndryshme, që nga frika e së panjohurës se çfarë pasojash do të sillte ky virus në jetën tonë, ku, për hir të së vërtetës, pasojat janë dëshpëruese. Secili prej nesh, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo, është përballur edhe me humbje jete në rrethet tona më të afërta shoqërore apo, fatkeqësisht, edhe familjare. A nuk mjafton kjo vallë për të kuptuar pasojat e shifrave të larta të infektiveve në çdo vend të botës? Aq më tepër që shifrat e fataliteteve apo edhe thirrjet e atyre qytetarëve të ndryshëm, që nga të moshuarit e gratë shtatzëna apo edhe të rinj që kanë rrezikuar jetën, madje nga spitali, të penduar që nuk e kanë bërë vaksinën, apelojnë që në emër të jetës dhe shëndetit të të gjithë atyre që nuk e kanë bërë ende vaksinën, të shpejtojnë ta bëjnë atë, sepse është e vetmja zgjidhje dhe e vetmja rrugëdalje nga kjo pandemi, që me variante të ndryshme e me valë të reja infektimesh nuk dihet se kur dhe si do të përfundojë?

Të gjithë jemi të lodhur nga masat shtrënguese që qeveria është e detyruar të marrë, që nga mbajtja e maskave, distancimi social, ora policore apo kryerja e testeve të Covid-19, kur lëvizim në vende të ndryshme. Por a nuk është më e drejtë të bëjmë vaksinën, e cila kërkon vetëm 1 minutë kohë për t'u aplikuar dhe, nëse arrijmë atje ku duhet, të shpresojmë që jeta jonë dhe e atyre që na rrethojnë të jetë e sigurt dhe e gjithë situata të përmirësohet? Ndaj, me thirrjen për t'u vaksinuar të gjithë qytetarët, që ende nuk e kanë bërë vaksinën, ftoj, gjithashtu, kolegët ta miratojmë këtë projektligj. Faleminderit!